



Voskopoja nje teritor me zhvillim dinamik dhe te qendrueshem

2007-2012



Pergatitur nga ADAD:
Msc. Hafuz DOMI

Voskopoje Tetor 2012

PERMBAJTJA

1.	Voskopojat nje komune me zhvillim dinamik dhe te qendrueshem:	3
2.	VOSKOPOJA-Teritori, burimet dhe sektoret kryesor	4
2.1	Te dhena te pergjithshme:	4
2.2	Burimet kryesore ne Voskopoje;	Error! Bookmark not defined.
3.1	Strategjia e zhvillimit te teritorit;	6
3.3	Sektori Privat	Error! Bookmark not defined.
3.4	Vleresimi teritorit te Voskopojes nga aktore	6
3.5	Projekti per Zhvillimin e Integruar te Teritorit te Voskopojes 2007-2012	6
4.	Dinamika e zhvillimit ekonomik te teritorit Voskopoje 2007-2012	7
5.	Bujqesia	7
5.1	Prodhimi bujqesor	7
5.2	Fondi i tokes	8
5.3	Prodhimet kryesore bujqesore	8
5.3.2	Prodhimi blegtoral	10
5.3.3	Bletari;	11
5.4	Faktoret:	11
5.5	Organizimi prodhuesve:	11
5.6	Tregtimi;	12
5.7	Prodhimet dhe produktet bujqesore per tregun turistik	12
5.8	Rezultatet kryesore	12
6.	Trashegimia	13
7.	TURIZMI	14
8.	Strukturimi aktorve	21
9.	Shtirirja e demarshit ne teritore te tjera te rajonit Korce	22
12.	Aktivite te qendrueshme per te ardhmen	23
13.	Programe per te ardhmen ne Rajonin e Korçes	23
	Aneks 1 Te dhenat ne bujqesi	24
	Aneks 2 Te dhena per popullsine dhe turizmin	27

Lista e Ankroneve

ADAD	Shoqata e Zhvillimit te Bujqesise te Rretheve Malore, www.adadmalore.al
DE	Delegacioni European ne Tirane
FERT	FERTILE (Groupe FERT) Paris, www.fert.fr
FZM	Forumi i Zonave Malore
GM	Grupi i Mbeshtetjes (nga lider grupesh Voskopoje)
Gpi	Grupi Pilotimit (partneret e projektit FERT dhe Komuna Voskopoje)
QIT	Qendra e Infomacionit Turistik Voskopoje
SHATM	Shoqata e Agroturizmit, trashegimise dhe Mjedisit Voskopoje
PSF	Patrimoine Sans Frontiere France
PCCC	Shoqata per Mbrojtjen e Siteve te Vogla me Karakter France

Voskopoja nje komune me zhvillim dinamik dhe te qendrueshem:



Nexhip Bacelli Kryetar i Komunes Voskopoje

Voskopoja ose Moskopoli (siç quhej në shek. 17^{të} e 18^{të}) është një nga pikat më të fuqishme turistike e kulturore në rajonin e Korçës. Kjo i dedikohet pozicionit gjeografik malor, peisazhit të bukur gjithëvjetor, historisë thuasje legjendare, trashigimise kulturore e fatare të këtij qyteti të dikurshëm.

Ka nje infrastrukture pergjithesisht te mire dhe funksionale. Ka nje vleresim dhe ruajtje te trashigimise se infrastruktures se vjeter kryesisht te rrugeve dhe trotuarve me gure dhe ka ndertime dhe rindertime prej guri etj.

Strategjia e zhvillimit te teritorit te Voskopojes mbeshtetet ne planet strategjike te hartuar nga FERT/ADAD ne 2006 dhe rinovuar ne 2011. Sektorët kryesor jane turizmi, bujqesia dhe sektori privat e artizanal, qe perbejne bazen e aktivitetit te komunitetit dhe te bizneseve qe veprojne ne Voskopoje.

Ne pese vitet e fundit 2007-2012 kane ndodhur shume ndryshime, si ne planin e zhvillimit ekonomik, social-kulturor dhe te organizimit te komunitetit, kjo per shkak te vullnetit dhe angazhimit te komunes dhe komunitetit, te projektit te Delegacionit e European te zbatuar nga FERT Paris dhe ADAD, ku eshte perfshire dhe ka perfituar i gjithe komuniteti i teritorit te Voskopojes.

*Sot kemi nje rigjallerim te Voskopojes, permiresim te infrastruktures urbane dhe turistike, vleresim te burimeve dhe sitit, organizimi inisiativave – krijimi shoqates Voskopoja, kthim te emigranteve, ngritja e bizneseve dhe ndertime te reja, kapacitete me te medha prithe turistike. Krahasuar me vitin 2005, aktualisht kemi dhjete fishim te numrit te turisteve, trefishim te sipërfaqeve me pemetore, dyfishim te prodhimit bujqësor e blegtoral, me shume prodhime e produkte bujqësore dhe artizanale, me shume punesim, me shume te ardhura dhe nivel me te larte ekonomiko-social, **tregues keto qe tregojne per nje zhvillim dinamik dhe te qendrueshem te teritorit te Voskopojes.***

Per te ardhmen ne do te perforcjome arritjet tona dhe do te shtojme vlere te reja per Voskopojen, qofte ne infrastrukture per ndertimin e rrugeve me kalldrete te Voskopojes, te ambjenteve kulturore e sportive, permiresimin e sherbimeve te pritjes turistike, te ruajtjes se mjedisit dhe te mbrojtjes se SITIT TE VOSKOPOJES, ne menyre qe Voskopoja te ringrihet ne vlerat e saj historike dhe te jete qender e rendesishme e terheqjes turistike.

Une me dashamiresi ju ftoj te vizitoni Voskopojen dhe do jeni gjithenje te mirepritur ne Voskopoje.

1. VOSKOPOJA

Te dhena te pergjithsheme:

Komuna Voskopoje ndodhet rreth 20 km ne perendim te Qytetit te Korces dhe shtrihet ne pllajen mes Gores dhe Oparit, me lartesi mesatare 1260 m lartesi mbi det dhe ka nje siperfaqe te pergjitheshme prej 64 km². Ka pese fshatra si: Voskopoja (qendra e komunes), Gjonomadhi, Lavdari, Shipska dhe Krushova, me largesi mesatare 5-7 km nga qendra. Ka 750 familje dhe rreth 2745 banore.

Burimet kryesore ne Voskopoje;

Vend malor, me pejsazh dhe bukuri natyrore, klime te fresket dhe kurative
Trashgimni te pasur historiko, monumentale dhe arkitekture, me kisha, ura, cezme etj.
Sasira te konsiderueshme blloqe guri per ndertim te objekteve dhe rrugeve.
Siperfaqe bujqesore, pyjore, kullosore, shumellojshmeri bimesh medicinale etj.

Natyra dhe mjedisi :

Vend malor me pejsazh dhe bukuri natyrore, me gjelbrim, klime verore te fresket dhe bore ne dimer, me ajer te paster dhe kurative. Me burime ujrore te mjaftueshme dhe kuruese, si dhe perrenjte qe pershkruajne teritorin, gje qe i japin bukuri dhe pastrim te ketij vendi.
Siperfaqe pyjore (me pishe) e kullosore, me flore dhe faune te pasur natyrore.
Vlerat natyrore dhe te krijuara nga njeriu te mjedisit sherbejne per nje terheqje te turistevet.
Pista e skive ka sherbyer per kampionatet qe jane zhvilluar ne Voskopoje, eshte nje vlere qe duhet vleresuar ne te ardhmen.

Historiku Voskopojes:

Voskopoja ka qene nje qyteze e krijuar rreth viteve 1338, ku kulmin e arriti rreth viteve 1750 duke qene nje qender e rendesishme urbane, tregtare dhe kulturore ne Shqiperi dhe ne ballkan. Ka pasur nje popullsi rreth 30 mije banore, me 24 kisha me afreske nga me te bukurat, akademine, shtypeshkronje etj.. Ka qene shume i zhvilluar artizanati, blegtoria duke perbere nje baze te mire per zhvillimin e tregtise duke u bere nje qender e rendesishme historiko-kulturore e ekonomike ne vend, ballkan e me gjere.

Trashegimia kulturore dhe fetare

Voskopoja ka nje trashgimni te pasur kulturore e monumentale. Kete e tregon prania e 7 kishave dhe manastiri te Shen Prodhomit. Nder to Kisha e Shen Thanasit eshte nga me te njohurat dhe cilesuar si "Sixstina e Ballkanit". Kisha e Shen Gjergjit ne Shipske eshte nje vlere, jo vetem nga ana fetare, por dhe nga ana arkitekture. Ka pasur shtypeshkronje, akademi dhe shume figura te shquara ne vend dhe Europe. Voskopoja ka te trasheguar nje infrastrukture te njohur me rruge me kallreme, shtepi karakteristike me gure te gdhendur, ura, cezme etj. Vleresimi i trashegimise i kane dhene mundesi njohje dhe zhvillimit te ketij teritori. Ne Voskopoje behen festa fetare dhe tradicionale, me e njohur eshte festa e Shen Prodhomit dhe Panairi ose sic quhet « Dita Turistike » qe behen me 24 Qershor te cdo viti.

Zhvillimi i Infrastruktures;

Ka nje infrastrukture pergjithesht te mire dhe funksionale, me rruge lidhese brenda teritorit te Voskopojes, rrjet te ujesjellesit dhe kanalizimeve te ujerave te zeza, me shkolla, qendra shendetesore, rrjet elektrik, telefonik dhe televiziv.

Eshte miratuar Plani Urbanistik per fshatin Voskopoje qe permban nje harmonizim te tradites me modernen dhe sherben si baze per ndertimin dhe zhvillimin e Voskopojes ne te ardhmen.

Ka nje vleresim dhe ruajtje e trashgimnise se infrastruktures se vjeter kryesisht te rrugeve dhe trotuarve me gure dhe ka ndertime dhe rindertime prej guri etj.

Gjate periudhes 2007-2012 jane realizuar 32 projekte ne infrastrukture me vlere XXX €, kryesisht ne rrjetin rrugor, ujesjelles, kanlizime, shkolla, qendra shendetesore, lulishte, pastrim mjedisi rruge, trashegimi ne restaurim kishash etj., duke i dhene nje pamje te nje teritori qe zhvillohet, me gjalleri dhe me patenciale per zhvillim.

Sporti

Sporti i skive eshte tradite ne Voskopoje per te gjithë, por duhet te theksojme qe voskopojaret perpara viteve 1990 kane qene pjese e ekipit te skive te Skenderbeut qe i perket Rajonit Korce. Voskopoja ka nxjere skiatore te talentuar dhe kampion kombetar, ku mund te permendim si Pirro Lola, Kristaq Janko, Anton Falo, Lida Samaraj, Sofika Zguri etj.

Pas viteve 1990 Voskopoja ka ekip te vetin, qe konkurron ne kampionatin kombetar te skive. Ekipi drejtohet nga ish skiatori kampion Anton Falo dhe qe kane arritur rezultate shume te mira ne shkalle kombetare. Ne kampionatin e fundit te zhvilluar ne Dardhe te Korces, Anxhelina Falo eshte shpallur kampione e Shqiperise per te reja.

Turizmi:

Turizmi eshte nje aktivitet kryesor qe ka filluar te aplikohet pas viteve 2000, por qe ka marre nje zhvillim te vrullshem pas vitit 2007. Sot ka 50 familje qe merren me turizem dhe ka nje rrjet hotelesh, shtepi te turizmit familjar, kafe e restorante, njesi sherbimi per turistet qe se bashku perbejne nje kapacitet prites per turistet. Eshte ngritur infrastuktura e orinetimit dhe informimit me sinalistike, harta, guida etj.,. Ka nje fluks ne rritje te turisteve nga viti ne vit. Turistet vijne nga rajoni Korces, Shqiperise, Europes e me gjere.

Bujqesia

Ka 6400 ha toke, 2500 ha jane toke bujqesore, ka livadhe dhe kullote, pyje, shumellojshmeri bimesh medicinale, kapacitete baze per zhvillimin e bujqesise dhe blegtorise. Bujqesia eshte burim kryesor i te ardhurave per 650 familje qe banojne ne teritorin e Voskopojes. Me te zhvilluar eshte pemetaria, vecanerisht kumbulla, si dhe patatja, fasulja, perimet, drithera etj. Blegtoria ze peshen kryesore dhe mbareshtohen kryesisht delja, gjedhi dhe bleta.

Te gjitha produkte bujqesore dhe blegtorale shquhen ne rajon dhe me gjere per cilesine e tyre dhe vecanerish, kumbulla, patatja, mjalti, mishi dhe bulmeti.

Organizimi komunitetit:

Komuna si institucion Publik eshte me qender ne Voskopoje dhe administron te gjithë territorin e Voskopojes. Si tradite dhe ndergjegjegjes voskopojare ka pas organizim te komunitetit sic eshte shoqata "Rilindja Voskopojare", e themeluar ne 1929 tregon me se miri per nivelin e organizimit dhe te kontributeve te voskopojareve. Voskopja ka pasur figura te shquara brenda dhe jashte vendit si Teodor Kavalioti, David Selenica, Vellezrit Zografi, vellezerit Sina, familjet Fundo, Ballauri, Falo, etj.

Sektori Privat

Veprojne rreth 35 subjekte private ne fushen e turizmit, sherbimeve etj.. Ka nje ritem te ndertimeve te reja, ne shtepi banimi, objekte ne sherbim te turizmit si hotele, restorante, njesi tregtare etj.

2. Faktoret kryesore qe kane ndikuar ne zhvillimin e integruar te territorit te Voskopojes

2.1 Strategjia e zhvillimit te teritorit;

Strategjia e zhvillimit te teritorit eshte venia ne eficiency te te gjitha resurseve dhe vlerave per zhvillimin turistik dhe ekonomiko-social te teritorit. *Plani strategjik perfshinte te gjithe sektoret e zhvillimit te teritorit te Voskopojes, projekti te DE-FERT ka perfshire tre sektore bujqesine, turizmin dhe vleresimin e trashigimise, ndersa komuna Voskopoje, ka punuar per realizimin e projekteve ne infrastrukturen e pergjitheshme dhe sektore te tjere.*

Ne themel te projekteve te realizuara dhe qe do te realizohen qendron plani strategjik i hartuar nga Fert/adad dhe komuna ne vitin 2006 dhe i rinovuar ne vitin 2011 i cili sherben si udherrefyes per zhvillimin e teritorit te Voskopojes.

2.2 Vleresimi teritorit te Voskopojes nga aktore

- Qeveria shqiptare mbeshtetur ne rendesine qe paraqet teritori Voskopojes, per historine, trashegimine kulturore-fetare dhe vlerat turistike e ka shpallur Voskopojen Zone Turistike ne vitin 1992 dhe Qender Historike ne vitin 2003.
- Organizata franceze PSF ka zhvilluar nje aktivitet te rendesishem ne Voskopoje, per restaurimin e kishave, vleresimin dhe promovimin e Sitit te Voskopojes (2002-2009).
- Qarku Korçe dhe shume organizata rajonale si SNV, DMO, GIZ kane promovuar vlerat voskopojsare nepermjet publikimit te materialeve informative, guidave, websiteve etj.
- FERT Paris dhe ADAD kane bere nderhyrjen me te rendesishme dhe afategjate qe nga viti 2004-2012 nepermjet nje procesi shoqerimi qe ne hartimin e Planit Strategjik, hartimin dhe zbatimin e nje projekti per zhvillimin e teritorit te integruar te Voskopojes, me mbeshtetjen e Delegacionit European.

2.3 Projekti per Zhvillimin e Integruar te Teritorit te Voskopojes 2007-2012

- Ky projekt e ka bazen tek Plani Strategjik i Voskopojes, ku inicimi dhe realizimi i ketij ne Voskopoje eshte bere nga FERT/PSF, Komuna dhe ADAD ne vitin 2005 me perfshirjen e komunitetit dhe aktorve lokal e qendror qe ndikojne dhe veprojne ne teritorin e Voskopojes. Mbeshtetur ne Planin Strategjik u hartua projekti per venien ne jete e planit strategjik per zhvillimin e teritorit te Voskopojes » dhe ju paraqit Delegacioni European ne vitin 2007, te cilin e miratoj.
- Projekti eshte lançuar ne janar te vitit 2008 ne Voskopoje me pjesemarrjen e te gjithe aktorve te perfshire ne auditet dhe aktivitetet e hartimit te Planit Strategjik ne 2005.
- Partneret e projektit FERT Paris, Komuna Voskopoje, ndersa ADAD ka zbatuar dhe administruar projektin ne Voskopoje. Ky projekt ka synuar vleresimin e burimeve te teritorit te Voskopojes per zhvillimin e turizmit, te bujqesise, ruajtjen e vleresimi e trashegimise te sitit te Voskopojes.
- *Jane kryer aksione per zhvillimin ekonomiko-social dhe organizmin e komunitetit, te cilet kane pas nje impakt te madh per gjithe teritorin e e Voskopojes. Mund te permendim rritjen e prodhimit bujqesor e artizanal, vleresimin e trashegimise, rritjen e numrit te turisteve ne Voskopoje, krijimi i shoqates Voskopoja dhe shtrirjen e demarshit ne komuna te tjera si Drenova e Vithkuqi te Korçes.*

2.4 Metoda e perdorur

Zhvillimi i nje teritori eshte i lidhur me resurset natyrore, pozicioni gjeografik, klima, trashigimia, por e rendesishme eshte se si do te administrohen keto pasuri ne te ardhmen. Eshte perdore nje metode e thjeshte dhe mjaft efikase, qofte ne hartimin e planit strategjik, ashtu dhe ne zbatimin e projektit. Gjithenje puna ka nisur me degjimin e komunitetit, te aktoreve dhe ka identifikuar situaten dhe aksionet qe duhet te ndermerren ne te ardhmen. Mbeshtetur ne propozimet e komunitetit, te inisiativave dhe aktoreve, duke qene njekohesisht, propozues, vendimarrës dhe zbatues te aksioneve.

Bashkepunimi Komune - FERT Paris, ka qene ne mbeshtetje te pjesemarrjes dhe vendimarrjes se komunitetit. Mbeshtetur ne elementet e metodes jane propozuar nga inisiativa, grupe dhe aktore aksione te cilat jane miratuar nga GM dhe KoPi. Keto aksione jane realizuar me sukses, sepse kane qene aksione qe siguronin punesim, risi, te ardhura, impakt dhe vazhdimesi per te ardhmen. Jane propozuar 133 Fische Aksione dhe jane miratuar dhe realizuar 120 aksione ne funksion te zhvillimit ekonomik-social te teritorit te Voskopojes. Gjithashtu shume rendesishme ka qene vendosja e nje ekipi ne vend per shoqerimin e projektit.

3. Dinamika e zhvillimit ekonomik te teritorit Voskopoje 2007-20012

Plani strategjik perfshinte te gjithe sektoret e zhvillimit te teritorit te Voskopojes, komuna Voskopoje, si autoritet lokal, realizimin e projekteve ne infrastrukturen e pergjitheshme e ka pare ne funksion te zhvillimit te sektorve te tjere dhe ne bashkepunim me FERT, ne kuader te projektit DE, kane mbeshtetur zhvillimin bujqesise, turizmit dhe vleresimin e trashigimise.

Gjate periudhes 2005-2011 kane ndodhur shume ndryshime, si ne planin e zhvillimit ekonomik, ashtu dhe ne ate te social-kulturor dhe te organizimit te komunitetit.

Gjate zbatimit te projektit eshte perfshire i gjithe komuniteti i teritorit te Voskopojes, ku kane perfituar rreth 650 familje ne bujqesi, nepermjet rritjes se prodhimit bujqesor dhe artizanal, te cilin e kane tregtuar reth 90 % ne Voskopoje, 50 familje ne sektorin e turizmit te cilet kane pritur me shume vizitore 55 mije ne vit, kane permiresuar sherbimin dhe kane shtuar kapacitetet pritesore per turistet me nje akomodim ditor rreth 400 shtreter. Eshte permiresuar shume infrastruktura e pritjes turistike, me harta, guida, flete palosje, guida, vizita te kishave, shetitje ne natyre etj.

4. Bujqesia

Pas viteve '90, situata ne bujqesi degradoi e shoqeruar me nje zhvillim spontan te bujqesise e pa orientuar dhe organizuar dhe shume veshtiresi ne teknologji e marketing te prodhimit, por pas viteve 2000 dhe sidomos pas vitit 2007, situata ne bujqesi ndryshoj, familjet ju kthyen bujqesise dhe sot ky sektor perben nje potencial ne prodhimin bujqesor dhe te ardhurave te familjeve ne teritorin e Voskopojes.

4.1 Prodhimi bujqesor

Territori i Voskopojes eshte shume i favorshem per bujqesine sepse ka kushte klimatiko-tokesore te favorshme, me toke te mire dhe burime ujore. *Ka 6400 ha toke, 2500 ha jane toke bujqesore, ka livadhe dhe kullote, pyje, shumellojshmeri bimesh medicinale, kapacitete baze per zhvillimin e bujqesise dhe blegtorise. Bujqesia eshte burim kryesor i te ardhurave per 650 familje qe banojne ne teritorin e Voskopojes. Me te zhvilluar jane, vecanerisht kumbulla, patatja, fasulja, perimet, drithera etj. Blegtoria ze peshen kryesore dhe mbareshtohen kryesisht delja, gjedhi dhe bleta. Prodhimet e Voskopojes jane te pelqyera ne tregun e Korces e me gjere per cilesine e tyre, vecanerisht, kumbulla, patatja, mjalti, mishi e bulmeti.*

Ne kuader te projektit te FERT, jane realizuar shume aksione per permiresimin dhe rritjen e siperfaqeve te ujiteshme, shtimit te siperfaqeve ne pemetari, permiresimit te farave e inpueteve bujqesore, permiresimit racor ne gjedh, te imta dhe blete, mekanizimit te proceve ne bujqesi e blegtori, si dhe aftesimit profesional te prodhuesve. Nga zbatimi i ketyre aksioneve prodhuesit kane arritur rezultate shume inkurajuese.

4.2 Fondi i tokes

Tabela 1 te dhenat per token are dhe ujitjen

Emertimi	Njesia	2008	2009	2010	2011	2012
Toke are	ha	418.5	423.5	451	490	500
Toke e ujiteshme	ha	117	117	117	237	247

Kemi rritje te siperfaqes se ujiteshme me 2.6 here dhe te siperfaqes se punueshme me 20 %, kjo per shkak te investimit nga projekti te venies ne pune te rezervuarit te Gjonomadhit, ku kane perfituar mbi 200 familje te Gjonomadhit dhe Lavdarit, te cilat kane rrit rendimentin dhe volumin e prodhimit bujqesore.

4.3 Prodhimet kryesore bujqesore

Aktiviteti bujqesor perben sektorin baze te ekonomise per bujkerit, sepse siguron punesim, prodhime dhe te ardhura per familjet e tyre.

Tabela 2; Struktura e prodhimit bujqesor

Kultura	Siperfaqe ha					Prodhimi kv				
	2008				2012	2008	2009	2010	2011	2012
Drithera	182				215	4113				6656
Patate	48				60	9600				19200
Perime	9				20	375				238
Fasule	25				14	375				238
Fruta	21				67	1200				4840

Tabela 3 Rendimenti per kulturat kryesore

Kultura	Njesia	2008	2009	2010	2011	2012
Drithera	kv/ha	23	28	27	30	27
Fruta	"	80	89	103	71	88
Patate	"	200	246	250	285	295
Perime	"	97	118	160	168	180
Fasule	"	15	15	17	17	17

Ne periudhen pesevjecare kemi te njejten tendence;

- rritjen e siperfaqes se kulturave bujqesore
- rritje te prodhimit, qe eshte bere me shume per shkak te rritjes se rendimentit se sa te rritjes se siperfaqes.

- Kumbulla dhe patatja jane kulturat me te rendesishme per tregun e turistik te Voskopojes.


Pemetari: Kumbulla ka pas nje zhvillim te madh, sidomos ne Gjonomadh dhe Lavdar, refereuar vitit 2008, siperfaqja eshte rritur me 42 ha, ndersa prodhimi me 364 ton ose 4 here ne shume. Krahas shtimit te siperfaqes, jane kryer shume aksione qe kane synuar organizmin e fermerve ne grup, formime, testime, per zgjidhur bashkerisht, ceshtje te asistences teknike, te futjes dhe aplikimit te teknologjise se re, te perdorimit te mekanikes, te tregtimit etj.

Eshte zbatuar teknologjia e re per 42 ha ne kumbulles me forme kurore Aks dhe eshte permiresuar teknologjia ne 20 ha pemetore ekistuese. Jane ngritur pemetore pilot, ku eshte testuar teknologjia e re dhe jane bere formime profesione te pemetarve. Keto pemetore jane fute 2-3 vjet me shpejt ne prodhim dhe kane marre rendiment 2 here me te larte.

Jane aftesuar mbi 200 pemetare nga ana profesionale per ngritjen, formimin dhe mirembajtjen e pemetoreve dhe prodhimit.


Aktualist rreth 30 % e kumbulles perpunohet ne menyra artizanale per prodhim raki, e cila tregtohet dhe konsumohet e gjitha ne Voskopoje. Grupi pemetarise eshte grupi me i organizuar, qe ka testuar teknika te reja, kane perdorur logon "Voskopoja" ne tregtimin e prodhimit, kane vleresuar cmimin me 500 leke/kv etj. Prodhimi shitet ne Voskopoje Korce dhe me gjere.

Pas 2-3 vitesh parashikohet qe prodhimi i kumbulles te jete mbi 8000 kv fruta.



Patatja eshte kulture kryesore, siperfaqja eshte shtuar me 12 ha, ndersa rritja e prodhimit eshte 840 ton me shume, kjo tregon se rritja ka ardhur nga rritja e rendimentit, i cili eshte rrit rreth 9.5 ton/ha, kjo per shkak te permiresimit te teknologjise, perdorimit te farave te zgjedhura dhe te testuara me pare ne Voskopoje dhe futjes se mekanizimit. Pra patatja pervec cilesise se larte, preferohet nga tregu dhe ka dhe cmim te mire, gje qe ndikon ne rritjen e te ardhurave per familjet bujqesore. Patatja eshte kulture kryesore dhe nga viti ne vit ka pas rritje te siperfaqes dhe te rendimentit.

Jane testuar mbi 10 varietete patatesh dhe jane perdorur 2-3 varietete me te mira, te cilat kane ndikuar ne rritjen e rendimentit me 50-70 kv/ha.



Ne vitin 2012, kater prodhues jane organizuar ne grupin e prodhimit e patates organike. Kane mbjelle 2 ha dhe kane prodhuar 500 kv te certifikuar nga "Albinspekt". Per kete prodhim te certifikuar eshte prodhuar etiketa per pataten organike me logon voskopoja, e cila do te tregtohet me cmim me te larte. Kjo eshte jo vetem nje iniciative cilesore, por eshte dhe nje aktivitet me te ardhme sepse jo vetem turistet, por konsumatori yne eshte i orientuar drejt cilesise dhe produkteve te teritoreve te vecanta. Ky aktivitet vlereson produktin e ketij teritori.

4.4 Prodhimi blegtoral

Ne voskopoje mbareshtrohen, kryesisht gjedhi, te imtat, bletet, shpendet, derrat, njethundraket dhe peshku Trofte, por perhapje me te madhe kane gjedhi, te imtat dhe bletaria.

Tabela 4; me te dhanat per kreret dhe prodhimin ne vite.

Kultura	Sasia / krere					Prodhimi kv				
	2008	2009	2010	2011	2012	2008	2009	2010	2011	2012
Blete	344	513	562	666	684	25.8	40	46.95	56.88	60
Qumesht lope	315	313	402	425	435	6300	6573	8563	9350	9570
Qumesht delje	2620	2582	3042	4032	4472	1740	1697	2182	2818	3279
Mish gjedhi	250	260	280	257	267	212.5	221	268.8	295.5	347
Mish te imtash	2050	2080	2200	1900	2140	360	378	424.5	454.4	499

Tabela 5; Rendimentet ne blegtori

Kultura	Njesia	2008	2009	2010	2011	2012
Qumesht lope	l/krere	2000	2100	2130	2,200	2200
Qumesht delje	"	60	60	61	61	62
Mish gjedh	kg/krere	85	85	96	115	130
Mish delje	"	18	18	18	22	23

- Blegtoria ka nje zhvillim pozitiv per gjate 5 viteve te fundit, ka rritje te numrit te krereve, rendimentit, te prodhimit dhe te vleresimit te shitjes se prodhimit dhe produktit.
- Kemi rritje te rendimentit te qumeshtit dhe te mishit ne gjedh per shkak te permiresimit racor nepermjet insiminimit artificial, kryerjes vaksinimit dhe mbareshtimit me te mire.
- Blegtoret jane aftesuar per mbareshtimin e blegtorise, kane realizuar shendetesimin nepermjet vaksinimit te 100 %. Kane permiresuar racen 90 % ne gjedh nepermjet Insiminimit Artificial me racen Tarantaise dhe Alpine, ndersa 80 % ne te imta me raca te reja dhe racen e vendit.
- Permiresimi Racor; Vicat e lindur me IA (Insiminim Artificial) kane peshe me te madhe ne lindje, shtese peshe me te madhe dhe per tre muaj ato arrijne mbi 100 kg mish, me nje vlere 70-80 mije leke ose rreth 15 mije leke me shume se vicat e lindur me insiminim natyral.
 - Me IA, lopet kane gjendje shendetesore me te mire, zgjedh racen qe deshiron per mish, qumesht apo te kombinuar. Kemi rritje te rendimentit me 200 litra krere.
 - Kemi perhapje te races Tarantaise rreth 60 % dhe jane perdorur per remond rreth 150 vica ose rreth 1/3 e numrit total te lopeve.
 - Krahas rritjes se numrit te krereve ne te imta, nje tendence pozitive eshte rritja e madhesis se tufes, ku 31 tufa kane 3150 krere ndaj 4472 krereve ose 70 % te numrit si komune.
 - Rreth 60 % e prodhimit, shitet dhe perpunohet ne menyre artizanale ne Voskopoje. Pjesa tjeter shitet me kontrata ne Boboshtice.
 - Grupi blegtorise ka mbeshtetur formimin dhe vendosjen e nje specialisti per Inisiminim artificial dhe sherbimin veterinar ne Voskopoje, aktivitet ky me vazhdimesi ne te ardhmen.

4.5 Bletari;

Bletaria eshte aktivitet me shume perspektive ne te ardhmen, per shkak te cilesise se larte te mjaltit qe preferohet nga turistet dhe konsumatori vendas, ku kjo i dedikohet flores se pasur malore te Voskopojes.

Tabela 6;


Emertimi	Njesia	2008	2009	2010	2011	2012
Koshere	cope	344	513	562	666	684
Rendimenti	kg/koshere	7.5	7.7	8.3	8.54	8.7
Prodhimi	kv	25.8	40	47	57	60

- Gjate periudhes pesevjecare kemi permiresim racore me mema te reja, kemi rritje te numrit te koshereve, te rendimentit, dyfishim te prodhimit, te mekanizimit te vjeljes se mjaltit.
- Eshte permiresuar marketingu i mjaltit, sot perdoren vazo qelqi dhe me "logon" e Voskopojes, kjo ka cuar ne vleresimin e cmimit me plus 50 % ndaj 2007.
- Eshte rritur interesi per bletarine dhe nga 14 bletar sot kemi 24 bletare.
- Bletaret jane aftesuar nga ana teknike dhe profesionale per mbareshtimin e bletes, per prodhimin e memave, qumeshtit te bletes.
- Me e rendesishmja eshte rritur interesi per bletarine, ku tashme kemi nje grup te organizuar dhe qe do te funksionoje dhe ne te ardhmen per te siguruar asistencen teknike, per mbareshtimin, marketingun e mjaltit etj.

4.6 Faktoret:

Si faktor ne zhvillimin bujqesor **mund te permendim:**

- Vullnetin dhe perkushtimin i prodhuesve
- Metoda e ndjekur per organizimin, angazhimin dhe pjesmarrja ne vendimarrje
- Mbeshtetja e iniciativave dhe grupeve me inpute, fara, fidane, baze gjenetike, mjete mekanike nga projekti i Delegacionit European.
- Aftesimi profesional nepemjet trajnimeve, vizitave, testimeve/eksperimentimeve
- Futja dhe aplikimi i teknologjive te reja ne pemetari, patate etj.
- Permiresimi i farave dhe i races ne gjedh, te imta dhe blete.
- Asistenca teknike dhe shoqerimi i projektit nga adad dhe fert.



4.7 Organizimi prodhuesve:

- Ne te gjitha teritorin e Voskopojes, 420 prodhues jane te organizuar ne 6 grupe (ujitje, drithera, pemetari, patate, bletari dhe blegtori) te cilat perfaqesohen nepermjet liderve te tyre ne Grupin e Mbeshtetjes, ku sot ne Shoqaten Voskopoja. Por brenda ketij

organizimi, prodhuesit janë strukturuar në 15 nëngrupe, të cilët kanë zgjidhur bashkërisht, çështje të përdorimit të mjeteve mekanike dhe shërbimet në ferme.

- Organizimi në grupe i ka dhënë mundësi, të sigurojnë asistencën teknike nga ADAD/FERT, formimit profesional në vend dhe Francë, të përdorin teknika dhe fara cilësore dhe të bëjnë përmirësimin racor, mekanizimin e procesve në bujqësi e blegtori dhe për rrjedhojë, kanë rritur rendimentin, prodhimin, cilësinë dhe çmimin.

4.8 Tregtimi;

- Prodhuesit duhet të prodhojnë produkte tradicionale dhe cilësore për tregun turistik dhe me gjere. Ato po bashkëpunojnë për të rritur sasinë, cilësinë dhe organizuar marketingun duke shfrytëzuar emrin e Voskopojës si logo për prodhimet e tyre.
- Ato kanë arritur të organizojnë tregtimin e prodhimit, të cilët kanë bashkëpunuar për vendosjen e logos "Voskopoja", cmimit të përbashkët dhe gjetjen e tregut. Nga amablazhimi dhe përdorimi i logos, Voskopoja ka arritur një tregtim të mirë dhe me një cmim rreth 15-25 % më të lartë.
- Në tregtimin e prodhimit dhe të produkteve, kanë realizuar marrëdhënie të ndërsjellta sektorin e turizmit me hotelet, restorantet, shtëpitë të pritjes familjare etj. Prodhimi i mjaltit dhe mishit shitet 100 % në Voskopojë. Prodherit kanë bërë shitje direkte të disa prodhimeve si të mjaltit, patates, bulmetit etj.

4.9 Prodhimet dhe produktet bujqësore për tregun turistik

- Në Voskopojë vizitorët që akomodohen në shtëpi familjare ju ofrohet dhe ushqimi, i cili është me prodhimet e tyre dhe të fshatit.
- Ndërsa në shërbimet në restorante, taverna ofrohen prodhime të vendit që janë shumë cilësore qoftë siç mund të përmendim, mish, peshk, mjalt, perime të konservuara, patate, fruta, bulmet, raki kumbulle etj.
- Duke pasur një fluks relativisht të lartë të turistëve, shumica e prodhimeve bujqësore dhe blegtorale konsumohen dhe shiten në tregun e Voskopojës.


4.10 Rezultatet kryesore

- Rritje të aftësisë ujtesë me 110 ha dhe të sipërfaqes së mbjelle
- Rritje të rendimentit të prodhimit bujqësor në grupe, patate, mjalt, fruta, etj.
- Përmirësimin racor në gjedh, të imta, blete dhe rritjen e rendimentit të prodhimit të qumështit, të mishit dhe të mjaltit
- Mekanizimi i disa proceseve në bujqësi ka sjellë uljen e kohës së punës me 10-30 here, ulje të kostos së prodhimit 10-15 here dhe për rrjedhojë përmirësim të nivelit të jetesës dhe të shëndetit të banorëve dhe vecanërisht të grave.
- Organizimin e prodhuesve për prodhime produkti teritori sic është prodhimi organik i patates.
- Vendosja e shërbimit teknike të insimit artificial pranë grupit të blegtorisë.
- Organizimi në grupe të prodhuesve.

Në territorin e Voskopojës rreth 80 % e familjeve merren me bujqësi dhe blegtori. Shumë familje kanë ngritur ferma relativisht të mëdha me pemetore, me tufa me të imta, me gjedhe, me blete, të cilat janë model në territorin e Voskopojës dhe vizita e në ferme është dicka shumë tërheqëse dhe e preferuar për vizitorët


5. Te ardhura nga sektori bujqesor

Prodhimi bujqesor dominon ndaj atij blegtoral me nje diference prej 10 %, pra te ardhurat nga kulturat bujqesore zene 55 %, kjo per arsye se ka shumica e familjeve merren dhe dalin ne treg me prodhim bujqesor, ndersa me blegtori merren me pak familje, per shkak te veshtiresise qe ka per dimrin e ftohte, megjithese ka kapacitete 2-3 here me te medha per shtimin e numrit te krereve.



Te ardhurat nga sektori bujqesor kane ardhur gjithenje ne rritje, kjo jo vetem per rritje te siperfaqes se mbjelle, apo shtimit te numrit te krereve, por me shume jane nga rritja e rendimentit dhe rritja e cmimit per shkak te cilesise dhe kerkeses se tregut turistik ne Voskopoje dhe te rajonit te Korce.

Te ardhurat ne sektorin bujqesor ne total jane rritur me 1.6 here, ndersa ai i kulturave bujqesore eshte rritur 1.8 here.



- Eshte rrit interesi per bujqesine
- Prodhuesit jane organizuar dhe kane krijuar marredhenie te koperimit, per kryerjen e sherbimeve dhe te tregut.
- Ka pas impakt aftesimi profesional, testimet per permiresimin e farave, racave, perdorimi i teknologjise se re dhe ka ndikuar drejteperdrejt ne rendiemnt dhe te ardhura me te larta.

6. Trashegimia

Emri i Voskopojes eshte i lidhur me kishat e saj dhe ne vecanti te afreskeve qe i zbukurojne ato, pikturuar nga te medhenjte e ikonografise pas-bizantine. Kjo trashegimi arkitekturore, artistike dhe arkeologjike pasqyrohet gjithashtu ne pasuri te tjera si artizanati, pervoja te ndryshme si (prodhime bujqesore, gure-gdhendje, qylima) pa harruar jeten kulturore (festa, ekspozita) dhe aspekti natyror (peisazhe, flora e fauna).

Drejtimet kryesore te projektit per trashegimine kane qene, vleresimi i trashegimise, krijimi i vlerave te reja dhe promovimi i sitit te Voskopojes. E rendesishme per kete eshte venia ne vlerë e kesaj trashegimie, per tu vizituar nga turistet. Eshte organizuar grupi i trashegimise, i perfaqesuar ne GM, ku ka miratuar dhe zbatuar aksione ne funksion te trashegimise.

Eshte bere publikimi i vlerave historike dhe te trashegimise, ne guiden turistike dhe ne sitin e internetit te Voskopojes, jane publikuar harta per intenerarin e vizitave ne kisha, eshte bere

markimi i shtigjeve dhe vendosur postera prane kishave per njohjen e vlerave te tyre nga turistet, jane botuar kartolina me pejsazhe, vepra monumentale dhe nga kishat e Voskopojes. **Per krijimin e vlerave te reja** eshte vendosur sinjalistika e orientimit dhe informimit per teritorin, historine dhe per sherbimet artizanale. Jane rindertuar dhe ndertuar çezme, lulishte, kend lojrash, ndertime te reja prej guri duke ruajtur traditen etj.

Eshte nxitur prodhimi artizanal i punimeve me dore si per qendisje, prodhim qylymash, te cilat jane shitur, jo vetem ne Voskopoje per turistet, por dhe ne tregun e Korces e Greqise.

Jane riprodhuar dy kostume tradicionale voskopojsare te grave si vlere e re qe i shtohet trashegimise kulturore te Voskopojes, te cilet jane ekspozuar tek Qendra e Informacionit te Turizmit. Sipas tradites ne Voskopoje ne ndertimet e reja perdoret guri gdhendur, punimet e drurit dhe te hekurit, keshtu qe eshte rigjallertuar shume punimi artizanal i guredhendjes, i hekurit, i drurit etj. Ata jane motivuar me pajisje per punime artizanale, kane marre pjese ne formiem profesionale dhe kemi promovuar prodhimet e tyre artizanale.

